



"AGRO  
GJEPALI"

"RISTORANTE E  
CONSULENZA"

MARRËVESHJE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE:

"AGRO GJEPALI SHPK"

*si Shoqëri përthithëse*

DHE

"RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"

*si Shoqëri e përthithur*





"AGRO  
GJEPALI"

"RISTORANTE E  
CONSULENZA"

## **"MARRËVESHJE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE "AGRO GJEPALI SHPK" DHE "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"**

Kjo marrëveshje lidhet sot më datë 03.10.2019 në Durrës, ndërmjet palëve të mëposhtme:

1. **SHOQËRIA "AGRO GJEPALI SHPK"**, person juridik që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli në Gjepalaj, Shijak, Durrës me NUIS L81316502S, e përfaqësuar nga administratori z.Fundim Gjepali, këtu e mëposhtë si Shoqëria Përthithëse

dhe

2. **SHOQËRIA "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"**, person juridik që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli në rrugën "Mustafa Matohiti", vila nr.2, Tiranë, me NUIS L61710036V, e përfaqësuar nga administratori z.Fundim Gjepali, këtu e mëposhtë si Shoqëria e Përthithur

Palët bien dakord si vijon:

### **1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME**

Në këtë marrëveshje (duke përfshirë dhe anekset bashkëlidhur), përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti ose përcaktohet ndryshe në vijim, fjalët e renditura mëposhtë kanë këto kuptime:

**"Marrëveshja"**- do të thotë kjo Marrëveshje Bashkimi me përthithje duke përfshirë si pjesë përbërëse të saj edhe anekset bashkëngjitur kësaj Marrëveshje, të cilat janë nënshkruar dhe shkëmbyer ndërmjet të dy shoqërive të përfshira në këtë proces riorganizimi të bashkimit me përthithje.

**"Ligji Tregtar"** do të thotë ligji nr.9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare "

**"Regjistri Tregtar "** do të thotë Regjistri Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR)

**" Kodi i Punës"** do të thotë ligji nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë "

**"Mbyllja"** do të thotë pranimi i të gjitha kushteve Marrëveshjes së Bashkimit dhe nënshkrimi e miratimi nga Asambletë e të dyja shoqërive të përfshira në këtë proces riorganizimi të bashkimit me përthithje.



"AGRO  
GJEPALI"

"RISTORANTE E  
CONSULENZA"

**"Data e mbylljes"** do të thotë data në të cilën do të kryhet mbyllja, pra data më e fundit e asamblesë përkatëse.

**"Data e ekzekutimit"** do të thotë data e regjistrimit të mbylljes në Regjistrin Tregtar pranë QKR.

**"Data e fundit kontabël"** do të thotë data 26.08.2019.

**"Periudha tranzitore"** do të thotë periudha kohore nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje (data e mbylljes) deri në datën e regjistrimit në QKR (data e ekzekutimit)

**"Aktivet dhe Pasivet e Transferuara"** do të thotë të gjitha aktivet dhe pasivet e transferuara nga shoqëria e përthithur tek shoqëria përthithëse, siç është përshkruar në këtë marrëveshje.

**"Bilanci i çeljes"** do të thotë bilanci i shoqërisë përthithëse pas konsolidimit të bilanceve të shoqërive **"AGRO GJEPALI SHPK"** dhe **"RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"** në datën e fundit kontabël dhe pasqyrimin në të të çdo ndryshimi të mundshëm të ndodhur mes datës së fundit kontabël dhe datës së mbylljes së bashkimit me përthithje.

Çdo dokument bashkëlidhur kësaj marrëveshje, duke përfshirë Anekset, është pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje dhe ka të njëjtën fuqi ligjore dhe efekt si kjo marrëveshje.

## 2. OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekti i kësaj marrëveshje është bashkimi me përthithje i shoqërisë **"RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"** nga shoqëria **"AGRO GJEPALI SHPK"**.

**"RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"** (shoqëria e përthithur) do të përthithet nga **"AGRO GJEPALI SHPK"** (shoqëria përthithëse) sipas kushteve të kësaj marrëveshje. Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me nenin 216, pika 1 e Ligjit Tregtar.

Në përputhje me nenin 215, pika 1 e Ligjit Tregtar, **"RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"** do të transferojë nëpërmjet bashkimit me përthithje, të gjitha aktivet dhe pasivet që zotëron tek shoqëria përthithëse **"AGRO GJEPALI SHPK"**.

Bazuar në nenin 220, paragrafi 3 të Ligjit Tregtar, pas regjistrimit të bashkimit me përthithje në QKR, ekzistenca e shoqërisë **"RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"** do të vlerësohet e prishur dhe shoqëria **"AGRO GJEPALI SHPK"**, shoqëria përthithëse, do të vijojë të ekzistojë me emrin **"AGRO GJEPALI SHPK"**.

Kjo marrëveshje hartohet në përputhje dhe në zbatim të vendimeve të asamblesë së ortakëve të shoqërive pjesëmarrëse në këtë proces riorganizimi. Këto vendime janë në aneks të kësaj marrëveshje.



"AGRO  
GJEPALI"

"RISTORANTE E  
CONSULENZA"

### 3. BILANCET NË MBYLLJE DHE BILANCI I ÇELJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Bashkimi me përthithje do të bazohet në pasqyrat financiare të shoqërive "AGRO GJEPALI SHPK" dhe "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK" të datës 26 gusht (data e fundit kontabël) si dhe çdo ndryshim në pozicionin financiar të shoqërive deri në datën e mbylljes.

Bilanci i çeljes së shoqërisë përthithëse "AGRO GJEPALI SHPK" do të bazohet në bilancin e konsoliduar të Datës së fundit kontabël të të dyja shoqërive përpara përthithjes. Çdo ndryshim, saktësim dhe korrigjim i mundshëm i Bilancit të çeljes, i realizuar mes Datës së fundit kontabël dhe Datës së mbylljes së bashkimit me përthithje duhet të raportohet dhe të miratohet nga Asambletë e ortakëve të të dyja shoqërive.

Pasqyrat e pozicionit financiar të të dyja shoqërive si në Datën e fundit kontabël paraqiten në aneks të kësaj marrëveshje.

### 4. AKTIVET DHE PASIVET E TRANSFERUARA

Në bazë të nenit 215, pika 1 e Ligjit Tregtar, shoqëria "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK" do t'i transferojë shoqërisë përthithëse "AGRO GJEPALI SHPK", kundrejt kuotave të kësaj të fundit, të gjitha aktivet dhe pasivet e veta sipas bilancit të Datës së fundit kontabël, duke marrë parasysh edhe çdo ndryshim të ndodhur deri në datën e mbylljes së bashkimit me përthithje.

Aktivet dhe pasivet përfshijnë çdo të drejtë dhe detyrim të njohur si të tillë në pasqyrat financiare, bazën e të dhënave, furnitorëve, listën e konflikteve apo proceseve të pazgjidhura si dhe çdo marrëdhënie tjetër kontraktore që ekziston në datën e ekzekutimit të mbylljes.

Të drejtat dhe detyrimet tatimore të shoqërisë së përthithur "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK", do t'i transferohen shoqërisë përthithëse "AGRO GJEPALI SHPK", si të gjitha llojet e tjera të të drejtave dhe detyrimeve, siç rezultojnë në pasqyrat financiare të Datës së fundit kontabël.

Më transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, "AGRO GJEPALI SHPK" do të marrë në zotërim të gjitha dokumentet, librat, korrespondencat, regjistrimet, marrëveshjet apo çdo dokument tjetër që provon ekzistencën e të drejtave dhe detyrimeve që do të transferohen.

Për të drejta apo detyrime të veçanta për të cilat do të nevojitet miratimi i një palë të tretë, ky miratim do të merret paraprakisht.



"AGRO  
GJEPALI"

"RISTORANTE E  
CONSULENZA"

Për pasuritë e paluajtshme shoqëria "AGRO GJEPALI SHPK" do të bëjë regjistrimet pranë Zyrrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Më transferimin e të gjitha aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur tek shoqëria përthithëse, kjo e fundit do të gëzojë të drejtën për të ngritur pretendime ligjore ndaj këtyre aktiveve si dhe do të mbartë detyrimin për t'u përgjigjur kundrejt pretendimeve që mund të ngrenë palë të treta në lidhje me detyrimet e shoqërisë së përthithur.

Të drejtat dhe detyrimet e shoqërive "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK" dhe "AGRO GJEPALI SHPK" kundrejt njëra tjetrës do të shuhen në Bilancin e Çeljes së shoqërisë përthithëse.

Marrëdhënie të caktuara kontraktuale të shoqërisë së përthithur me palë të treta (kontrata shërbimi të ndryshme, ), nëse pas vlerësimit se nuk do t'i shërbejnë shoqërisë përthithëse pas bashkimit, mund të vendoset që të zgjidhen para ose pas datës së regjistrimit të bashkimit me përthithje, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe parashikimet e këtyre kontratave për zgjidhjen e tyre.

## 5. RAPORTI I KËMBIMIT TË KUOTAVE

Të dyja shoqëritë kanë të njëjtën strukturë kapitali. Kapitali i tyre përbëhet nga 1 kuotë e cila zotërohet 100% nga z. Fundim Gjepali, por edhe pse zotërohen nga i njëjti individ shoqëritë nuk kanë lidhje të kapitalit me njëra-tjetrën.

Meqënëse të dy shoqëritë e përfshira në këtë proces bashkimi janë nën kontrollin e të njëjtit individ, z. Fundim Gjepali, i cili është ortak i vetëm dhe zotëron 100 % të kapitalit, edhe në shoqërinë përthithëse edhe në atë të përthithur, nuk do të ketë ndryshime të raportit të kuotave. Kapitali do të përllogaritet me anë të metodës së Vlerës Neto të Aseteve ose ndryshe Vlera Kontabël e Kapitalit.

| ( të dhënat në lekë ) | AGRO GJEPALI SHPK | RISTORANTE<br>E CONSULENZA SHPK | AGRO GJEPALI SHPK<br>pas bashkimit |
|-----------------------|-------------------|---------------------------------|------------------------------------|
| Total Asete           | 56 304 262        | 5 276 804                       | 59 218 858                         |
| Total Detyrime        | 53 044 865        | 390 166                         | 51 072 824                         |
| Asete Neto            | 3 259 397         | 4 886 638                       | 8 146 035                          |



"AGRO  
GJEPALI"

"RISTORANTE E  
CONSULENZA"

## 6. KUSHTET E EKZEKUTIMIT TË BASHKIMIT

Përfundimi i plotë i transaksionit të përthithjes i nënshtrohet përmbushjes së kushteve mëposhtme përpara ekzekutimit:

- Asambletë e ortakëve të shoqërive AGRO GJEPALI SHPK dhe RISTORANTE E CONSULENZA SHPK duhet të kenë miratuar këtë marrëveshje dhe dokumentet e tjera që lidhen me të, në përputhje me nenin 218 të Ligjit Tregtar.

## 7. TË DREJTA TË VEÇANTA

Transferimi nuk prek të drejta të veçanta të ortakëve.

## 8. EFEKTET MBI PUNËMARRËSIT

Në datën e regjistrimit të bashkimit në QKR, të gjitha kontratat e punëmarrësve të shoqërisë përthithëse nuk do të kenë asnjë ndryshim. Shoqëria e përthithur nuk ka punëmarrës të tjerë përveç administratorit, efektet mbi të cilin do të sqarohen në pikën vijuese.

## 9. EFEKTET MBI ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË AGRO GJEPALI SHPK

Bashkimi me përthithje nuk do të sjellë asnjë ndryshim në organet drejtuese të shoqërisë përthithëse "AGRO GJEPALI SHPK". Në datën e ekzekutimit të bashkimit administratori i saj do të vijojë të jetë z. Fundim Gjepali, i cili po të njëjtën datë do të japë dorëheqjen nga pozicioni i administratorit të shoqërisë së përthithur "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK".

## 10. EFEKTET LIGJORE TË BASHKIMIT

Sikurse parashikon neni 220, pika 3 e Ligjit Tregtar, regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit :

1. Ka pasojë kalimin të shoqëria përthithëse të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë që përthithet. Ky transferim ka pasoja si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe te palët e treta;
2. bën që ortakët e shoqërisë së përthithur të bëhen ortakë të shoqërisë përthithëse;
3. bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, pa kaluar në procesin e likuidimit. Personaliteti juridik do të vijojë të ketë vetëm shoqëria përthithëse " AGRO GJEPALI SHPK "



"AGRO  
GJEPALI"

"RISTORANTE E  
CONSULENZA"

### **11. MBROJTJA E KREDITORËVE**

Kreditorët e shoqërive mbrohen në përputhje me nenin 221 të Ligjit Tregtar.

### **12. ZGJIDHJA E MARRËVESHJES**

Kjo marrëveshje mund të zgjidhet në çdo kohë përpara datës së ekzekutimit, me miratimin e dhënë me shkrim nga të dyja palët.

### **13. LIGJI I ZBATUESHËM DHE FORCAT MADHORE**

Kjo marrëveshje, në tërësi, do të qeveriset nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

Palët nuk mund të deklarohen përgjegjëse për mospërbushjen e detyrimeve përkatëse, kur kanë qenë nën ndikimin e forcave madhore të cilat kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në ekzekutimin dhe mbarëvajtjen normale të përmbajtjes së kësaj marrëveshje, për aq kohë sa do të vazhdojë të jenë nën ndikimin e këtyre forcave dhe për aq sa janë ndikuar në ekzekutimin e detyrimit përkatës.

Forca madhore do të konsiderohen të gjitha faktet dhe rrethanat që dalin jashtë kontrollit normal dhe të arsyeshëm të palëve dhe kanë ndikuar objektivisht në zbatimin e kësaj marrëveshje ose pjesëve të caktuara të saj.

Me përfundimin e periudhës së ndikimit apo efekteve të Forcave Madhore, palët do të vazhdojnë ekzekutimin normal të kësaj marrëveshje, sipas përmbajtjes.

Do të konsiderohen Forcë Madhore (jo në mënyrë shteruese) turbullirat civile, lufta, grevat, shkatërrimet nga katastrofat natyrore, çdo lloj akti ligjor dhe nënligjor miratuar pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje që ndikon drejtëpërdrejtë në ekzekutimin normal të kësaj marrëveshje etj.,

### **14. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE GJYKATA KOMPETENTE**

Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga ekzekutimi i kësaj marrëveshje.

Në qoftë se mirëkuptimi sipas paragrafit të parë të këtij neni nuk mund të arrihet, autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.



"AGRO  
GJEPALI"

"RISTORANTE E  
CONSULENZA"

## 15. TË NDRYSHME

### ➤ Shpenzimet

Shoqëria "AGRO GJEPALI SHPK" dhe "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK" do të marrin përsipër në mënyrë të barabartë shpenzimet në lidhje me bisedimet, zbatimin dhe mbylljen e çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për përthithjen.

### ➤ Ndryshime në Marrëveshje

Çdo ndryshim i kësaj marrëveshje do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar nga të dyja palët.

### ➤ Pavlefshmëria e pjesshme

Në rast se një pjesë e kësaj marrëveshje është ose shpallet e pavlefshme ose jo detyruese, pjesa tjetër mbetet e vlefshme dhe detyruese për palët.

### ➤ Gjuha

Kjo marrëveshje është hartuar në shqip.

## 16. LISTA E ANEKSEVE

- Aneks 1 – Vendimet e Asambleve të Ortakëve të shoqërive "AGRO GJEPALI SHPK" dhe "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK".
- Aneks 2 – Pasqyra e Pozicionit Financiar të Datës së Fundit Kontabël të "AGRO GJEPALI SHPK"
- Aneks 3 – Pasqyra e Pozicionit Financiar të Datës së Fundit Kontabël të "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"
- Aneks 4 – Aktivitetet dhe Detyrimet Tatimore të "RISTORANTE E CONSULENZA SHPK" (shoqëria e përthithur).
- Aneks 5 – Bilanci i Çeljes së Shoqërisë Përthithëse.
- Aneks 6 – Struktura e Re e Kapitalit të Ortakëve të "AGRO GJEPALI SHPK" pas Bashkimit me Përthithje.



"AGRO GJEPALI" shpk


Përfaqësues Ligjor

Fundim Gjepali

"RISTORANTE E CONSULENZA" shpk

Përfaqësues Ligjor

Fundim Gjepali







**"AGRO TJEPALI SHPK"**

**Aneks Nr.2**

Pasqyra e Pozicionit Financiar të Datës së Fundit Kontabël të shoqërisë  
**"AGRO TJEPALI SHPK"**



# "AGRO GJEPALI SHPK"

Si më datë 26.08.2019.

Pasqyra e pozicionit financiar të shoqërisë "RISTORANTE E CONSULENZA" SHPK është përgatitur në përputhje me SKK2.

| Nr  | A K T I V E T                                     | Shënime<br>shpjeguese | Periudha<br>2019 | Periudha<br>2018 |
|-----|---------------------------------------------------|-----------------------|------------------|------------------|
| I   | <b>AKTIVET AFATSHKURTRA</b>                       |                       | 5,841,523        | 8,351,818        |
| 1   | Mjetet monetare                                   | 1                     | 438,440          | 3,628            |
| 2   | Investime :                                       | 2                     | -                | -                |
| 3   | Të drejta të arkëtueshme :                        | 3                     | 5,057,839        | 8,355,446        |
| 4   | Inventari                                         | 4                     | 345,244          | -                |
| 5   | Shpenzime të shtyra                               | 5                     | -                | -                |
| 6   | Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara      | 6                     | -                | -                |
| II  | <b>AKTIVET AFATGJATA</b>                          |                       | 50,462,738       | 37,531,169       |
| 1   | Aktive financiare                                 | 7                     | -                | -                |
| 2   | Aktive afatgjata materiale                        | 8                     | 50,462,738       | 37,531,169       |
| 3   | Aktivitet biologjike afatgjata                    | 9                     | -                | -                |
| 4   | Aktive afatgjata jo materiale                     | 10                    | -                | -                |
| 5   | Aktive tatimore të shtyra                         | 11                    | -                | -                |
| 6   | Kapitali i nënshkruar i papaguar                  | 12                    | -                | -                |
|     | <b>TOTALI AKTIVEVE (I+II)</b>                     |                       | 56,304,262       | 45,882,987       |
| I   | <b>DETYRIMET AFATSHKURTRA</b>                     |                       | 9,925,057        | 8,413,707        |
| 1   | Detyrime afatshkurtra                             | 13                    | 9,925,057        | 8,413,707        |
| 2   | Të pagueshme për shpenzime të konstatuara         | 14                    | -                | -                |
| 3   | Të ardhura të shtyra                              | 15                    | -                | -                |
| 4   | Provizione                                        | 16                    | -                | -                |
| II  | <b>DETYRIMET AFATGJATA</b>                        |                       | 43,119,808       | 36,800,000       |
| 1   | Detyrime afatgjata:                               | 17                    | 33,119,808       | 33,800,000       |
| 2   | Të pagueshme për shpenzime të konstatuara         | 18                    | -                | -                |
| 3   | Të ardhura të shtyra                              | 19                    | 10,000,000       | 3,000,000        |
| 4   | Provizionet afatgjata                             | 20                    | -                | -                |
| 5   | Detyrime tatimore të shtyra                       | 21                    | -                | -                |
|     | <b>TOTALI DETYRIMEVE (I+II)</b>                   |                       | 53,044,865       | 45,213,707       |
| III | <b>KAPITALI</b>                                   |                       | 3,259,397        | 669,280          |
| 1   | Kapitali dhe Rezervat                             | 22                    | -                | -                |
| 2   | Kapitali i Nënshkruar                             | 23                    | 100              | 100              |
| 3   | Primi i lidhur me kapitalin                       | 24                    | 0                | 0                |
| 4   | Rezerva rivlerësimi                               | 25                    | -                | -                |
| 6   | Rezerva                                           | 26                    | -                | -                |
| 7   | Fitimet e pashperndara                            | 27                    | 669,180          | -                |
| 8   | Fitimi (Humbja) e vitit financiar                 | 28                    | 2,590,116        | 669,180          |
|     | <b>TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)</b> |                       | 56,304,261       | 45,882,987       |

"AGRO GJEPALI" shpk, Gjepalaj, Shijak, Durrës



**"RISTORANTE E CONSULENZA" SHPK**  
**NUIS L61710036V**

**Aneks Nr.3**

Pasqyra e Pozicionit Financiar të Datës së Fundit Kontabël të shoqërisë  
**"RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"**

**"RISTORANTE E CONSULENZA" SHPK**  
**NUIS L61710036V**

Si më datë 26.08.2019.

Pasqyra e pozicionit financiar të shoqërisë "RISTORANTE E CONSULENZA" SHPK është përgatitur në përputhje me SKK2.

| Nr  | A K T I V E T                                | Shënime shpjeguese | Periudha 2019 | Periudha 2018 | Periudha 2017 |
|-----|----------------------------------------------|--------------------|---------------|---------------|---------------|
| I   | AKTIVET AFATSHKURTRA                         |                    | 5,276,804     | 5,458,570     | 5,329,588     |
| 1   | Mjetet monetare                              | 1                  | 76,869        | 695,089       | 1,644,835     |
| 2   | Investime :                                  | 2                  | -             | -             | -             |
| 3   | Të drejta të arkëtueshme :                   | 3                  | 5,199,935     | 4,763,481     | 3,684,752     |
| 4   | Inventari                                    | 4                  | -             | -             | -             |
| 5   | Shpenzime të shtyra                          | 5                  | -             | -             | -             |
| 6   | Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara | 6                  |               |               |               |
| II  | AKTIVET AFATGJATA                            |                    | -             | -             | -             |
| 1   | Aktive financiare                            | 7                  | -             | -             | -             |
| 2   | Aktive afatgjata materiale                   | 8                  | -             | -             | -             |
| 3   | Aktivet biologjike afatgjata                 | 9                  |               |               |               |
| 4   | Aktive afatgjata jo materiale                | 10                 | -             | -             |               |
| 5   | Aktive tatimore të shtyra                    | 11                 |               |               |               |
| 6   | Kapitali i nënshkruar i papaguar             | 12                 | -             | -             | -             |
|     | TOTALI AKTIVEVE (I+II)                       |                    | 5,276,804     | 5,458,570     | 5,329,588     |
| I   | DETYRIMET AFATSHKURTRA                       |                    | 390,166       | 198,208       | 744,016       |
| 1   | Detyrime afatshkurtra                        | 13                 | 390,166       | 198,208       | 744,016       |
| 2   | Të pagueshme për shpenzime të konstatuara    | 14                 | -             | -             | -             |
| 3   | Të ardhura të shtyra                         | 15                 |               |               |               |
| 4   | Provizione                                   | 16                 | -             | -             | -             |
| II  | DETYRIMET AFATGJATA                          |                    | -             | -             | -             |
| 1   | Detyrime afatgjata:                          | 17                 | -             | -             | -             |
| 2   | Të pagueshme për shpenzime të konstatuara    | 18                 | -             | -             | -             |
| 3   | Të ardhura të shtyra                         | 19                 | -             | -             |               |
| 4   | Provizionet afatgjata                        | 20                 | -             | -             | -             |
| 5   | Detyrime tatimore të shtyra                  | 21                 |               |               |               |
|     | TOTALI DETYRIMEVE (I+II)                     |                    | 390,166       | 198,208       | 744,016       |
| III | KAPITALI                                     |                    | 4,886,638     | 5,243,339     | 4,585,572     |
| 1   | Kapitali dhe Rezervat                        | 22                 | -             | -             | -             |
| 2   | Kapitali i Nënshkruar                        | 23                 | 100           | 100           | 100           |
| 3   | Primi i lidhur me kapitalin                  | 24                 | 0             | 0             |               |
| 4   | Rezerva rivlerësimi                          | 25                 | -             | -             | -             |
| 6   | Rezerva                                      | 26                 | -             | -             | -             |
| 7   | Fitimet e pashperndara                       | 27                 | 5,260,262     | 4,585,472     | (191,836)     |
| 8   | Fitimi (Humbja) e vitit financiar            | 28                 | (373,724)     | 674,790       | 4,777,308     |
|     | TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)   |                    | 5,276,804     | 5,458,570     | 5,329,588     |

"RISTORANTE E CONSULENZA" SHPK, Rr. Mustafa Matoshi, Vllaz. 2, Tiranë

Ristorante & Consulenza  
 Sh.p.k.  
 NUIS : L 61710036 V  
 Tiranë - Albania

**"RISTORANTE E CONSULENZA" SHPK**  
**NUIS L61710036V**

**Aneks Nr.4**

Aktivitet dhe Detyrimet Tatimore të **"RISTORANTE E CONSULENZA SHPK"**  
(Shoqëria e përbërë).

**"RISTORANTE E CONSULENZA" SHPK**  
**NUIS L61710036V**

Të drejtat dhe detyrimet Tatimore të shoqërisë "RISTORANTE E CONSULENZA" shpk, në përputhje me pasqyrën e pozicionit financiar, janë paraqitur si vijon:

(0 Lekë)

**Të drejta tatimore**

|                           |             |
|---------------------------|-------------|
| Tatim Fitimi i Thjeshtuar | 17 023 lekë |
| Sigurime shoqërore        |             |
| TAP                       |             |
| Tatim në Burim            |             |
| TVSH                      |             |

**Total Aktive Tatimore** **17 023 lekë**

**Detyrime tatimore**

|                           |            |
|---------------------------|------------|
| Tatim Fitimi i Thjeshtuar |            |
| Sigurime shoqërore        | 7 254 lekë |
| TAP                       |            |
| Tatim në Burim            |            |
| TVSH                      |            |

**Total Detyrime Tatimore** **7 254 lekë**



65EPAL



**"AGRO GJEPALI SHPK"**

### **Aneks Nr.5**

**Bilanci i Çeljes së shoqërisë "AGRO GJEPALI" shpk**  
**(Shoqëria Përthithëse)**



## "AGRO GJEPALI SHPK"

Bilanci i çeljes së shoqërisë përthithëse është bilanci i konsoliduar pas bashkimit me përthithje që nga data e fundit kontabël të të dyja shoqërive në fjalë.

Pasqyra e konsoliduar e shoqërisë pas bashkimit

Datë 26.08.2019

| Nr  | A K T I V E T                                | Shënime shpjeguese | Agro Gjepali | Ristorante Consulenza | Agro Gjepali Pas bashkimit |
|-----|----------------------------------------------|--------------------|--------------|-----------------------|----------------------------|
| I   | A K T I V E T A F A T S H K U R T R A        |                    | 5,841,523    | 5,276,804             | 8,756,120                  |
| 1   | Mjetet monetare                              | 1                  | 438,440      | 76,869                | 515,310                    |
| 2   | Investime :                                  | 2                  |              |                       |                            |
| 3   | Të drejta të arkëtueshme :                   | 3                  | 5,057,839    | 5,199,935             | 7,895,567                  |
| 4   | Inventari                                    | 4                  | 345,244      |                       | 345,244                    |
| 5   | Shpenzime të shtyra                          | 5                  |              |                       |                            |
| 6   | Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara | 6                  |              |                       |                            |
| II  | A K T I V E T A F A T G J A T A              |                    | 50,462,738   |                       | 50,462,738                 |
| 1   | Aktive financiare                            | 7                  |              |                       |                            |
| 2   | Aktive afatgjata materiale                   | 8                  | 50,462,738   |                       | 50,462,738                 |
| 3   | Aktivet biologjike afatgjata                 | 9                  |              |                       |                            |
| 4   | Aktive afatgjata jo materiale                | 10                 |              |                       |                            |
| 5   | Aktive tatimore të shtyra                    | 11                 |              |                       |                            |
| 6   | Kapitali i nënshkruar i papaguar             | 12                 |              |                       |                            |
|     | TOTALI AKTIVEVE (I+II)                       |                    | 56,304,262   | 5,276,804             | 59,218,858                 |
| I   | D E T Y R I M E T A F A T S H K U R T R A    |                    | 9,925,057    | 390,166               | 7,953,016                  |
| 1   | Detyrime afatshkurtra                        | 13                 | 9,925,057    | 390,166               | 7,953,016                  |
| 2   | Të pagueshme për shpenzime të konstatuara    | 14                 |              |                       |                            |
| 3   | Të ardhura të shtyra                         | 15                 |              |                       |                            |
| 4   | Provizione                                   | 16                 |              |                       |                            |
| II  | D E T Y R I M E T A F A T G J A T A          |                    | 43,119,808   |                       | 43,119,808                 |
| 1   | Detyrime afatgjata:                          | 17                 | 33,119,808   |                       | 33,119,808                 |
| 2   | Të pagueshme për shpenzime të konstatuara    | 18                 |              |                       |                            |
| 3   | Të ardhura të shtyra                         | 19                 | 10,000,000   |                       | 10,000,000                 |
| 4   | Provizionet afatgjata                        | 20                 |              |                       |                            |
| 5   | Detyrime tatimore të shtyra                  | 21                 |              |                       |                            |
|     | TOTALI DETYRIMEVE (I+II)                     |                    | 53,044,865   | 390,166               | 51,072,824                 |
| III | K A P I T A L I                              |                    | 3,259,397    | 4,886,638             | 8,146,035                  |
| 1   | Kapitali dhe Rezervat                        | 22                 |              |                       |                            |
| 2   | Kapitali i nënshkruar                        | 23                 | 100          | 100                   | 5,633,172                  |
| 3   | Primi i lidhur me kapitalin                  | 24                 | 0            | 0                     | 0                          |
| 4   | Rezerva rivlerësimi                          | 25                 |              |                       |                            |
| 6   | Rezerva                                      | 26                 |              |                       | 296,470                    |
| 7   | Fitimet e pashperndara                       | 27                 | 669,180      | 5,260,262             |                            |
| 8   | Fitimi (Humbja) e vitit financiar            | 28                 | 2,590,116    | (373,724)             | 2,216,393                  |
|     | TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)   |                    | 56,304,261   | 5,276,804             | 59,218,859                 |

AGRO GJEPALI SHPK

Përfaqësues Ligjor

"AGRO GJEPALI" shpk, Gjepalaj, Shijak, Durrës





**"AGRO GJEPALI SHPK"**

### **Aneks Nr.6**

Struktura e Re e Kapitalit, Ortakëve të **"AGRO GJEPALI SHPK"**, administratori, selia dhe objekti i shoqërisë pas Bashkimit me Përthithje.

---

*"AGRO GJEPALI" shpk, Gjepalaj, Shijak, Durrës*



**"AGRO GJEPALI SHPK"**

### **Selia e shoqërisë**

Selia e shoqërisë **"AGRO GJEPALI SHPK"**, person juridik që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, pas bashkimit do të vijojë të jetë në **Gjepalaj, Shijak, Durrës**.

### **Administratori**

Administratori i shoqërisë pas bashkimit do të vijojë të jetë, z.Fundim Gjepali. Afati i emërimit të tij do të jetë 5-vjeçar nga data e miratimit të bashkimit

### **Objekti i veprimtarisë**

Aktivitete të agroturizmit dhe zhvillim rural, restoranti dhe të ngjashme; merr, trajton, ruan, magazinon, prodhon, përpunon, tregton, blen, shet ose merret me çdo menyrë a mjet tjetër me produkte bujqësore. Të ushtrojë aktivitet në fushën e përpunimit, ambalazhimit, marketimit dhe tregtimit të produkteve blegtorale, bujqësore, shtazore dhe të gjitha derivateve të tyre dhe të kryejë çdo veprim tjetër që lidhet me prodhimin, përpunimin dhe tregtimin në fushën e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tërësi, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Shoqëria ka të drejtë të mundësojë trajnime profesionale për palet e treta, të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, të vendose pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë. Mbarështimi blegtorial të imta dhe të trasha, mbarështim dhe prodhim bletësh. Prodhim, shitje, import-eksport të prodhimeve blegtoriale si mish, bulmet, mjaltë, etj. Grumbullim, shitje import-eksport të bimëve dhe frutave. natyrale mjeksore dhe përpunimin e tyre në barna popullore, etj. Të ushtrojë aktivitet trajnues në fushat e mësipërme dhe në fushën e promocionit territorial dhe zhvillimit të qëndrueshëm; Të kryejë çdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin. Të zotërojë kuota/aksione apo çdo lloj interesi tjetër në shoqëri të tjera, pavarësisht fushës në të cilën kryejnë veprimtari këto shoqëri. Të kryejë çdo veprim tjetër në përmbushje të interesave dhe nevojave të shoqërisë dhe sipas dispozitave të statutit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.



"AGRO GJEPALI SHPK"

### Struktura e Re e Ortakëve të "AGRO GJEPALI SHPK" pas Bashkimit me Përthithje.

Meqënëse të dy shoqëritë e përfshira në këtë proces bashkimi janë nën kontrollin e të njëjtit individ, z. Fundim Gjepali, i cili është ortak i vetëm dhe zotëron 100 % të kapitalit, edhe në shoqërinë përthithëse edhe në atë të përthithur, nuk do të ketë ndryshime të raportit të kuotave. Kapitali do të përlogaritet me anë të metodës së Vlerës Neto të Aseteve ose ndryshe Vlera Kontabël e Kapitalit.

Përlogaritja si vijon :

| ( të dhënat në lekë) | AGRO GJEPALI SHPK | RISTORANTE<br>E CONSULENZA SHPK | AGRO GJEPALI SHPK<br>pas bashkimit |
|----------------------|-------------------|---------------------------------|------------------------------------|
| Total Asete          | 56 304 262        | 5.276 804                       | 59 218 858                         |
| Total Detyrime       | 53 044 865        | 390 166                         | 51 072 824                         |
| Asete Neto           | 3 259 397         | 4 886 638                       | 8 146 035                          |

Asetet Neto të detajuara do të jenë si vijon :

- ❖ 5 633 172 lekë kapitali themeltar
- ❖ 296 470 lekë rezervë ligjore
- ❖ 2 216 393 lekë fitimet deri në datën e fundit kontabël

Pas bashkimit struktura e kapitalit të ortakëve do të jetë :

| Nr. | Ortakët        | Kuota | Përqindja |
|-----|----------------|-------|-----------|
| 1.  | Fundim Gjepali | 1     | 100%      |

AGRO GJEPALI SHPK

Përfaqësues Ligjor

Fundim Gjepali

